



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
Drejtoria e Edukimit Parauniversitar

Nr. 5429 / Prot.

4

Tiranë, më 04.08.2010

MIRATOHET

MINISTRI

MYQEREM TAFAJ



PROGRAM MËSIMOR

PËR

KULTURËN E PËRGJITHSHME TË ARSIMIT PROFESIONAL –TEKNIK

DREJTIMI I ARSIMIT PROFESIONAL –TEKNIK: TË GJITHA DREJTIMET

LËNDA: EDUKIMI PËR KARRIERËN

Klasa e 11-të

Tiranë, Gusht 2010



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

**PROGRAMET E KULTURËS SË PËRGJITHSHME TË ARSIMIT
PROFESIONAL – TEKNIK (APT)**

**PROGRAMI I LËNDËS
EDUKIMI PËR KARRIERËN
Klasa e 11-të**

STRUKTURA e APT: 2+1+1 vite, 2 + 2 vite, bllok 4-vjeçare

DREJTIMI i APT: Të gjitha drejtimet e arsimit profesional-teknik

Koordinatori: MIRELA ANDONI

Redaktori: GAZMEND KRASNIQI

Përgjegjës sektori: MARITA HAMZA

TIRANË, KORRIK 2010

Nëpërmjet kësaj lënde nxënësit identifikojnë dhe hulumtojnë qëllimet e karrierës, zbatojnë aftësitë e komunikimit dhe mendimin kritik, zhvillojnë aftësitë punë kërkuese dhe planifikojnë/ marrin vendim për shkollimin/trajnimin e mëtejshëm dhe punësimin.

Formimi i karrierës është një proces që zgjat gjatë gjithë jetës. Ai fillon në familje, zhvillohet gjatë periudhës së shkollimit si dhe përvojave të punës dhe shfaqet/ njihet me aftësinë e individit për të marrë vendime për të ardhmen e tij, në përshtatje me statusin e kualifikimit dhe me ndryshimet e tregut të punës.

1. SYNIMI I LËNDËS

Kjo lëndë synon: të zhvillojë te nxënësi aftësi për të zbuluar mundësitë e karrierës, si dhe për të vetë vlerësuar interesat dhe prirjet e veta me qëllim vendimmarrjen për shkollimin/trajnimin e mëtejshëm dhe punësimin, për të qenë pjesëtarë funksionalë të shoqërisë.

2. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Në përfundim të zhvillimit të lëndës “Edukimi për karrierë”, nxënësi/ja:

- të përdorë dhe menaxhojë njohuritë, shprehjet e marra në lëndë të ndryshme në lidhje me hulumtimin, planifikimin dhe vendimmarrjen për karrierën;
- të përdorë familjen, shkollën, biznesin dhe sipërmarrjet nga komuniteti, si burime për të hulumtuar ndikimin e tyre në karakterin personal dhe etikën me qëllim planifikimin e karrierës;
- të fitojë njohuri, shprehje dhe ekspertizë nga një gjerësi burimesh me qëllim përmbushjen e qëllimeve të paracaktuara nga vetë ai/ajo për planifikimin e karrierës,
- të hulumtojë dhe planifikojë karrierën duke analizuar detyra dhe raste të suksesshme nga jeta e të rriturve, bota e punës dhe sipërmarrja;
- të vlerësojë në mënyrë kritike, në përputhje me interesat, prirjet dhe cilësitë vetjake, mundësitë e tij/saj për karrierën duke marrë parasysh konsumin dhe buxhetin personal, shëndetin dhe përgjegjësitë sociale, si dhe prirjet e tregut të punës;
- të planifikojë hapat për karrierën bazuar në vendimmarrje,
- të zbatojë elemente të sipërmarrjes në projekte konkrete.



3. OBJEKTIVA

a) Linja: Hulumtimi i karrierës

Përshkrimi i linjës: Nxënësi zhvillon aftësinë për të hulumtuar botën e punës, si dhe mundësitë për kualifikim të mëtejshëm, si një parakusht për arritjen e një vendimmarrjeje të studiuar mirë.

Orë të sugjeruara¹: 7

	Objektiva
Hulumtimi i karrierës	<p>Në përfundim të klasës 11-të nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none">• të argumentojë me shembuj lidhjet dhe ndryshimet midis punës, profesionit dhe karrierës;• të shpjegojë kuptimin dhe rëndësinë e kualifikimit në përgjithësi dhe atij profesional, në lidhje me statusin e punësimit;• të shpjegojë sistemin formal, informal, joformal të kualifikimit në Shqipëri;• të diskutojë ndikimin e kualifikimit në zhvillimin e karrierës;• të paraqesë prirjet e zhvillimit të punësimit në tregun lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar;• të paraqesë burimet kryesore të punësimit në tregun lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar të punësimit;• të identifikojë shërbimet kryesore sociale dhe zyrat e punësimit në tregun lokal;• të shpjegojë statusin e individëve në tregun e punës (i punësuar, i papunë, student, etj).• të listojë forma të ndryshme të ndihmës për të papunët;• të paraqesë shërbimet që ofrojnë zyrat e punësimit dhe ndihmës sociale në tregun lokal;• të paraqesë veprimtaritë ekonomike në tregun lokal;• të identifikojë profesionet që lidhen me veprimtaritë e shërbimit dhe ato të prodhimit në tregun lokal;• të argumentojë ndryshimet midis veprimtarive të ndryshme të punës;• të identifikojë rëndësinë e formave të ndryshme të punës duke përfshirë punën në familje, punën vullnetare, në komunitet;

¹ Orë të sugjeruara janë orët e planifikuara nga specialistët për zhvillimin e linjës. Shuma totale e orëve të linjave duhet të jetë sa numri i plotë i orëve në planin mësimor për këtë lëndë. Quhen të sugjeruara sepse i jepet liri zbatuesit të programit (mësuesit), që të shtojë ose të pakësojë numrin e sugjeruar të orëve në masën 10%, sipas nevojave të klasës.

	<ul style="list-style-type: none"> • të identifikojë ndryshimet kryesore midis shkollës dhe punës; • të shpjegojë burimet dhe mënyrat e ndryshme të ofrimit të vendeve të lira të punës; • të interpretojë informacionin nga burime të ndryshme për vende të lira pune. • të shpjegojë metoda të ndryshme për të kërkuar punë; • të shpjegojë kuptimin për njohuritë, shprehjet, qëndrimet në punë; • të investigojë karriera të ndryshme në tregun virtual dhe real të punës nëpërmjet instrumenteve të caktuara; • të tregojë nëpërmjet shembujve ndikimin e përvojave të ndryshme të punës, trajnimeve në karriera të ndryshme; • të investigojë në vendin e punës tri profesione të përzgjedhura; • të hartojë instrumentet e investigimit sipas formateve të përcaktuara dhe unifikuara nga mësuesi; • të paraqesë rezultatet e investigimit;
--	--

b) Linja: Vetëvlerësimi

Përshkrimi i linjës: Nxënësit gjykojnë dhe përgatisin informacionin për vetveten, duke marrë parasysh dhe ndikimet e mjedisit mbi ta.

Orë të sugjeruara 9

Vetëvlerësimi	<p>Në përfundim të klasës 11-të nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të identifikojë interesat dhe dëshirat personale për profesionin; • të argumentojë interesat dhe dëshirat personale për profesionin; • të bëjë vetëvlerësimin duke mbajtur parasysh dëshirat dhe interesat që lidhen për profesionin; • të vlerësojë/rivlerësojë aftësitë dhe prirjet personale të nevojshme në lidhje me profesionin; • të vlerësojë shëndetin personal (ndikimin edhe të medikamenteve, drogave, alkoolit) në lidhje me me profesionin; • të paraqesë shembuj nga realiteti lidhur me ndikimet e përdorimit në punë të medikamenteve, duhanit, alkoolit, drogës; • të vlerësojë ndikimin e rolit gjinor në profesion; • të identifikojë aspekte të sensualitetit, seksualitetit, intimitetit në raport me profesionin; • të identifikojë tipare, faktorë që ndikojnë në karriera të
----------------------	---

	<p>suksesshme;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të shpjegojë me shembuj si ndikojnë vendim-marrja, menaxhimi i kohës, stresi, konfliktet, planifikimi, etj, në suksesin në karrierë; • të listojë tiparet personale për të pasur karrierë të suksesshme në profesion. • të identifikojë anët e dobëta dhe të forta personale në lidhje me aftësitë sipërmarrëse; • të argumentojë gjykimin personal në lidhje me aftësitë sipërmarrëse, • të identifikojë trajnimet e duhura për zhvillimin e aftësive personale sipërmarrëse; • të identifikojë mundësitë personale për realizimin e nje veprimtarie sipërmarrëse. •
--	--

c)Linja:Planifikimi/ Vendim marrja për karrierën dhe sipërmarrien

Përshkrimi i linjës: Nxënësit aftësohen te hartojnë dhe të përshtatin planet për të udhëhequr ndryshimin dhe tranzicionin.

Orë të sugjeruara 14

<p>Planifikimi/ Vendim marrja për karrierën dhe sipërmarrien</p>	<p>Në përfundim të klasës 11-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të hartojë kërkesën për punë nëpërmjet letërkërkesës; • të hartojë kërkesën për punë nëpërmjet telefonit; • të hartojë kërkesën për punë në formë elektronike; • të plotësojë forma të gatshme aplikimi për punë; • të hartojë një “curriculum vitae” sipas formateve të qarta dhe konsistente, me gjuhë të qartë duke vënë në dukje (në formë imagjinare), aftësitë, cilësitë personale; • të shpjegojë llojet e intervistave për punë; • të shpjegojë hapat e përgatitjes për intervistën e punës (parapërgatitja, intervista, reflektimi); • të paraqesë procesin e parapërgatitjes për intervistë; • të paraqesë rregullat e komunikimit dhe etikën gjatë intervistës; • të paraqesë reflektimin në lidhje me intervistën; • të demonstrojë në një rast të simuluar interviste; • të shpjegojë procesin e planifikimit të karrierës; • të analizojë nëpërmjet analizës SWOT informacionin e mbledhur për të arritur në vendim marrje; • të shpjegojë procesin e vendimmarrjes për karrierën; • të hartojë qëllimin dhe objektivat për karrierën; • të planifikojë afatet kohore për çdo objektiv për karrierën;
---	---



	<ul style="list-style-type: none"> • të planifikojë buxhetin personal lidhur me karrierën; • të planifikojë strategjitë për karrierën personale; • të listojë elementet përbërës të portofolit për karrierën; • të plotësojë portofolin për karrierën sipas rubrikave; • të hartojë një plan veprimi për të përmirësuar aftësitë sipërmarrëse; • të identifikojë cilësi të personave të suksesshëm në sipërmarrje; • të hartojë një plan të strukturuar veprimi për të ndërmarrë një vizitë në një biznes lokal, • të vlerësojë përdorimin e informacionit dhe të teknologjive të komunikimit në një sipërmarrje biznesi; • të organizojë një takim/ bisedë në klasë me një sipërmarrës; • të menaxhojë realizimin e takimit/ bisedës sipas hapave dhe qëllimit të përcaktuar; • të përgatisë një raport mbi vizitën në një biznes lokal; • të ndërmarrë rol udhëheqës në grup në një veprimtari konkrete; • të planifikojë dhe të organizojë një mbledhje; • të paraqesë një detyrë konkrete në komunitet; • të bëjë vlerësimin (feed back-un) e veprimtarive të kryera (sukseset e arritura dhe vështirësitë e ndeshura). •
--	---

c) Linja: Hulumtimi i sipërmarrjes

Përshkrimi i linjës: Nxënësi zhvillon aftësinë për të hulumtuar botën e punës, si dhe mundësitë për kualifikim të mëtejshëm, si një parakusht për arritjen e një vendimmarrjeje të studiuar mirë.

Orë të sugjeruara 4

	Objektiva
Hulumtimi i sipërmarrjes	<p>Në përfundim të klasës 11-të nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të hetojë cilësitë dhe aftësitë e personave sipërmarrës; • të paraqesë cilësitë dhe aftësitë e personave sipërmarrës; • të hetojë shembuj të sipërmarrjeve në familje dhe komunitet; • të hetojë sipas hapave të paracaktuara sipërmarrje në komunitet; • të hetojë përvoja për mënyra të hapjes dhe mbajtjes së një sipërmarrje; • të paraqesë veçoritë e sipërmarrjeve në komunitet duke iu referuar produktit, shërbimit, tregut dhe forcave të punës;

	<ul style="list-style-type: none"> • të paraqesë në formën e një raporti përvojat e sipërmarrjeve të hetuara; • të identifikojë rëndësinë e arsimit dhe trajnimit në zhvillimin e një sipërmarrje;
--	--

4. KËRKESA TË LËNDËS “EDUKIMI PËR KARRIERËN” NDAJ LËNDËVE TË TJERA

Edukimi për karrierën	1. Matematika
Për të gjitha linjat	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të kryejë veprime matematikore në funksion të llogaritjes së buxhetit familjar dhe personal, për llogaritjen e nivelit të jetesës, • të interpretojë tabela, grafikë e diagrama statistikore që lidhen me prirjet e tregut të punës dhe punësimin.
Edukimi për karrierën	2. Gjuha shqipe
Për të gjitha linjat	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përdorë dhe të dijë kuptimin e termave dhe të koncepteve gjuhësore si: karriera, vendimmarrja, profesioni, kualifikimi, sipërmarrja, vetëvlerësimi, menaxhimi, konflikti, stresi, komunikimi, planifikimi etj., • të përdorë formatet e një kërkese, shkrese zyrtare, CV-je dhe formulari aplikimi, • të analizojë dhe interpretojë tekste të ndryshme në rastet e kërkimit të punës dhe analizës së tregut të punës, • të përdorë forma të ndryshme komunikimi në raste të intervistave, paraqitjes, diskutimit, • të shprehë opinione të arsyetojës, diskutojë, argumentojë dhe të bëjë debat në lidhje me tematika që lidhen me karrierat, sipërmarrjet e suksesshme, rolin gjinor dhe shëndetin në zgjedhjet e ardhshme, • të zhvillojë dialogë, të dëgjojë me vëmendje, të mbajë në vëmendje opinione, pikëpamje dhe të kontrollojë emocionet, • të bëjë prezantime (paraqitje) duke përdorur teknika të ndryshme.
Edukimi për karrierën	3. Gjuha e huaj
Për të gjitha linjat	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të analizojë dhe interpretojë informacione në gjuhë të huaj në lidhje me karriera dhe sipërmarrje te suksesshme,

	<p>njoftime për punësim;</p> <ul style="list-style-type: none"> të shfrytëzojë fjalorin terminologjik në gjuhë të huaj.
Edukimi për karrierën	4. TIK
Për të gjitha linjat	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> të përdorë programe të ndryshme për punët e pavarura dhe prezantimet e ndryshme (si word, excel, power point etj); të përdorë komunikimin elektronik (e-mail, rrjetin e brendshëm, internetin, etj) për të komunikuar dhe bashkëpunuar me të tjerët.
Edukimi për karrierën	- 5.Qytetari
Për të gjitha linjat	<p>Nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> të përdorë konceptet e familjes dhe komunitetit për të bërë analiza të ndryshme; të përdorë dhe të shfrytëzojë forma të ndryshme komunikimi; të vlerësojë mendime të tjetrit pa e paragjykuar atë; të zhvillojë dialogë, të dëgjojë me vëmendje, të tërheqë opinione dhe të shprehë pikëpamje duke qenë tolerant dhe joparagjykes; të njohë dhe shfrytëzojë mentalitetin familjar dhe të komunitetit në ndihmë të planifikimit të karrierës.

5. KËRKESAT PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Ky program është një dokument zyrtar. Ai është vetëm një pjesë e tërësisë së dokumenteve zyrtare për lëndën “Edukimi për karrierën”. Dokumentet e tjera kryesore janë korniza kurrikulare e arsimit profesional dhe standardet e kësaj fushe kurrikulare..

Për të siguruar përdorimin sa më të mirë të programit është e vlefshme njohja me dokumentet e lartpërmenduar.

Në kornizën kurrikulare vëmendje e veçantë i duhet kushtuar:

- synimeve të përgjithshme të kurrikulës së arsimit profesional,
- synimeve të linjave ndërkurrikulare,
- vlerësimit të nxënësit me notë,
- parimeve të mësimdhënie-mësimnxënies.

Në mënyrë që tërësia e dokumenteve zyrtare (korniza kurrikulare, standardet e fushës së të nxënësve dhe programi lëndor) të zbatohen më së miri në dobi të nxënësve, përdoruesit e tyre duhet të njohin thellë programet lëndore të lëndës “Edukimi për karrierën”.

Përdoruesve të këtyre dokumenteve u lind nevoja të njohin standardet e të gjitha fushave të tjera të të nxënësve dhe të gjitha programet lëndore të të njëjtit vit.



Objektivat e programit

Objektivat e programit janë për të gjithë nxënësit. Kjo do të thotë se që të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia që të nxënë çka përshkruhet tek objektivat. Realizimi i objektiveve në tema, kapituj e njësi dhe renditja e tyre është zgjedhje e lirë e zbatuesit të programit.

Kështu, për shembull, objektivi: "Nxënësi/ja të shpjegojë sistemin formal dhe joformal të kualifikimit në Shqipëri", do të thotë se të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia të njohin sistemet e kualifikimit në Shqipëri, strukturat e sistemit arsimor dhe të trajnimit, të dallojnë veçoritë dhe kohëzgjatjen e tyre, lidhjet dhe fleksibilitetin e këtyre sistemeve dhe mundësitë që krijojnë këto për vendim marrjen e pritshme të nxënësit.

Orët mësimore

Programi zbatohet me një ore javore: gjithsej ne 34 ore mësimore.

Programi "Edukimi për karrierën" është strukturuar në linja që vijnë njëra pas tjetrës. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, kurse janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën linjë. Mësuesi mund të vendosë të përparojë më ngadalë, kur vë re se nxënësit e tij hasin vështirësi të veçanta në përmbushjen e objektiveve të kapitullit, por mund të ecë më shpejt, kur nxënësit e tij demonstrojnë një përvetësim të kënaqshëm.

Në programin e lëndës "Edukimi për karrierën" afërsisht 40% e orëve mësimore totale janë për shtjellimin e njohurive të reja lëndore dhe 60% e tyre janë për përpunimin e njohurive (gjatë vitit dhe në fund të vitit shkollor).

Përpunimi i njohurive

Përpunimi i njohurive përmban:

- përsëritjen e njohurive-bazë (konceptet themelore),
- vlerësimin e njohurive-bazë,
- integrimin e njohurive të reja të një linje me njohuritë e linjave paraardhëse,
- integrimin e njohurive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera (integrimi do të përshkojë zhvillimin e çdo ore mësimore),
- detyrat/ projektet përmbledhëse vjetore (pavarësisht nga ndarja në linja lënda duhet parë si një e tërë),
- vlerësimi vjetor (nuk është i detyruar).

Në orët mësimore, që i përkasin përpunimit të njohurive, mësuesi zhvillon edhe tema me nismën e tij ose me kërkesën e vetë nxënësve. Këto tema mund të pikënisen nga ngjarje aktuale ose thjesht nga kureshtja e nxënësve.

Veçanërisht gjatë përpunimit të njohurive duhet t'i kushtohet kohë e posaçme kultivimit të:

- aftësive të përgjithshme si komunikimi, menaxhimi dhe transferimi i informacionit, të menduarit kritik dhe krijues, zhvillimi i karakterit dhe i etikës;
- aftësive të posaçme lëndore në lidhje vetëvlerësimin, paraqitjen, studimin e tregut të punës, hartimin e planit të punës dhe vendimmarrjen,

- formimit të qëndrimeve, si qëndrimi etiko-social dhe gjatë punës në grupe të vogla nxënësish.

Gjatë orëve të përpunimit të njohurive nxënësve duhet t'u krijohet mundësia të punojnë detyra tematike, projekte kurrikulare, të zgjidhin situata problemore nga jeta, etj.

Pjesë e përpunimit të njohurive është vlerësimi i realizimit të objektivave, i cili ka për qëllim të nxjerrë në pah shkallën e realizimit dhe të përforcojë, të përmirësojë njohuri e aftësi të pa përmbushura të kësaj lënde.

6. VLERËSIMI

Vlerësimi i nxënësit përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënësit është konsistent me objektivat e programit lëndor. Objektivi i vlerësimit janë njohuritë, shprehjet dhe qëndrimet e nxënësve (qëndrimet etiko-sociale në përgjithësi dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti).

Vlerësimi i nxënësit mund të bëhet në mënyrë individuale ose në grup. Nxënësi vlerësohet me notë ndërsa demonstroi arritjet e tij me gojë, me shkrim apo nëpërmjet veprimtarive të tjera.

Në këtë lëndë nxënësi vlerësohet për portofolin e detyrave, për prezantimet, hetimet e realizuara në përputhje me formularët standardë të përcaktuar nga mësuesi.

Në punime të nxënësve me grupe të vogla, mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënës në veçanti.

Nuk është i detyrueshëm vlerësimi me notë i nxënësve në çdo orë mësimore.

Mësuesi duhet tu parashtojë nxënësve qëllimin, kriteret dhe instrumentet e vlerësimit.

Portofoli i punëve të nxënësit është një nga mundësitë kryesore të vlerësimit për mësuesin dhe të vetëvlerësimit për nxënësin.